

PROBLEMS RELATED TO THE ORTHOGRAPHY AND SPELLING OF THE ENGLISH NAMES IN ALBANIAN LANGUAGE

PROBLEME TË LIDHURA ME DREJTSHKRIMIN DHE DREJTSHQIPTIMIN E EMRAVE TË PËVEÇËM ANGLEZË NË GJUHËN SHQIPE

ZAMIRA (METAJ) ALIMEMAJ & FARIE HODAJ

Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, shqipëri

zamiraalimema@gmail.com

AKTET VI, 5: 557-561, 2013

PERMBLEDHJE

Shumëkujt nga ata që nuk e ka humbur ndjesinë e gjuhës shqipe u vjen keq kur shikojnë titujt e gazetave të mbushura me fjalë të huaja, sidomos anglisht, apo të dëgjojnë në mediat e folura të përdoren emra të përvëçëm të huaj, të cilëve u mungon çdo kategori gramatikore e drejtshkrimore e shqipes. Në Kongresin e Drejtshkrimit u vendos që në drejtshkrimin e këtyre emrave të zbatohet parimi fonetik, por këto dekadat e fundit po vihet re që ky parim nuk po zbatohet. Emrat e përvëçëm të huaj po shkruhen sipas gjuhës prej nga merren. Ky punim ka për qëllim të bëjë një analizë të rasteve të thyerjes së normës standarde të drejtshkrimit të tyre, si dhe problemeve që krijohen lidhur me strukturat gramatikore të gjuhës shqipe, si për shembull, shquarsia, rasat, gjinia.

Fjalet kyce: emrat e përvëçëm, anglezë, norma gjuhësore, drejtshqiptimi, shquarsia, shkelje gjuhësore.

SUMMARY

A number of English names are used in Albanian in their English orthography. The adaption to the Albanian language of some words, especially the names is not going very smoothly, it is producing a number of grammatical or phonological problems. Some names of English origin are written with the English orthography, while some others are written according to the Albanian orthography. So there is a chaotic situation in the ways the proper names are written in the Albanian language. Some of the problems created by this situation are: the absence of the case endings, spelling and pronunciation. We should obey to the rules of the orthography of the Albanian Language.

Key words: names, orthography, English, language, Albanian, translate, rules.

Hyrje

Në nëntor 1972 u mbledh Kongresi i Drejtshkrimit, i cili shënoi një ngjarje të rëndësishme historike për gjuhësinë shqiptare, për kulturën dhe kombin shqiptar. Ai u quajt "Kongresi i Drejtshkrimit", sepse gjithë vëmendjen ia kushtoi njësimit të drejtshkrimit, si hapi i parë që shpie drejt normës letrare standarde. Aty u pat parasysh që në rregullat e drejtshkrimit të kombinohej drejt parimi fonetik me atë morfologjik e historik. Ky kongres pati rëndësi të veçantë, sepse ai zgjidhi përfundimisht

problemin e standardizimit të shqipes letrare. Kongresi i Drejtshkrimit, nëpërmjet njësimit të normës drejtshkrimore, mbështeste gjuhën letrare të njësuar, duke i dhënë kësaj një formë të vetme e të përbashkët për gjithë kombin shqiptar. Kështu, Kongresi vepronte sipas parimit "një drejtshkrim i njësuar, i vetëm për një gjuhë letrare të njësuar e të njëjtë për të gjithë shqiptarët".

Në vetë "Rregullat e drejtshkrimit të shqipes", si dhe në punimet e Kongresit, u diskutua për shumë çështje të normës gramatikore. U vunë në

dukje edhe disa të meta të Projektit, si dhe u ngritën probleme me interes, një ndër të cilët ishte edhe drejtshkrimi i emrave të përveçëm të huaj në gjuhën shqipe. Për rregullat se si duheshin shkruar këta emra pati dy qëndrime. Qëndrimin të parë i përkisnin ata që përkrahnin mendimin se emrat e përveçëm të huaj duhej të shkruheshin sipas traditës vendase, duke zbatuar drejtshkrimin e shqipes, sipas shqiptimit që kanë emrat e huaj në gjuhën prej nga merren. Qëndrimi i dytë u përkiste atyre që përkrahnin mendimin se emrat e përveçëm të huaj duhej të shkruheshin sipas grafisë në gjuhën dhënëse.

1. Roli i mjeteve të informimit dhe shkelja e normës drejtshkrimore në të gjitha rrafshet

Mjetet e informimit nuk janë vetëm kronikë e ngjarjeve në vend e në botë, por ato me rubrikat e shumëllojshme janë edhe tribunë e jetës kulturore, artistike, arsimore. Ato, siç thotë me të drejtë profesor Androkli Kostallari *janë një fushë e gjerë ku zbatohet e përpunohet gjuha letrare kombëtare* dhe, si të tilla luajnë rol të madh jo vetëm në emancipimin e masave të lexuesve, të dëgjuesve e të teleshikuesve, sepse ushtrojnë ndikim të drejtpërdrejtë, por edhe në përhapjen e ngulitjen e normës letrare, duke filluar nga nxënësit e gjer tek punonjësit e arsimit e të kulturës.

Prandaj fjala e shkruar në gazetë apo e transmetuar nëpërmjet radios e televizionit duhet t'u përgjigjet të gjitha kriterëve fonetike, morfologjike, sintaksore të gjuhës shqipe dhe pikërisht kjo fjalë të shërbejë si model i drejtshqiptimit, i drejtshkrimit dhe i normave morfologjike e sintaksore për të gjithë shqipfolësit. *"Nuk mund të jetë e lejueshme që në shtypin e në botimet tona të ndeshemi dendur me gabime trashanike drejtshkrimore e gramatikore; nuk mund të jetë e lejueshme që ta mbushim ligjërimin tonë thjesht "për modë" me fjalë të huaja krejt të panevojshme, ose që rrugët e qytetet të shëmtohen me lloj-lloj mbishkrimesh... nuk mund të jetë e lejueshme më në fund që padija gjuhësore e dikujt të paraqitet të paraqitet në vitrinën e gjuhës letrare, siç duhet të jetë gjuha*

e mediave dhe e botimeve në përgjithësi."(Lafe 1997).

Me vendosjen e demokracisë, me lindjen e shtëpive botuese e stacioneve radio-televizive private, u vunë re luhajtje dhe shtrembërime të theksuara të normës standarde në shkrimin e fjalëve e sidomos në drejtshkrimin e emrave të huaj të përveçëm, kryesisht atyre me origjinë amerikane e anglo-saksone që po vërshonin dhe vazhdojnë të vërshojnë në shkrimet tona. Në përkthimet e shumë veprave të huaja po rishfaqej edhe prirja e vjetër e të shkruarit të emrave me origjinë amerikane e anglo-saksone sipas ortografisë së gjuhës origjinale, praktikë kjo e ndjekur përpara Luftës së Dytë Botërore dhe në vitet e para të pasçlirimit.

Sot vemë re se praktikohen të dyja këto prirje:

(a) shkrimi i emrave të huaj të përveçëm sipas rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe d.m.th. sipas shqiptimit duke zbatuar ortografinë e gjuhës shqipe; dhe

(b) sipas ortografisë së gjuhës prej nga merren.

Përderisa ne kemi një rregullore të drejtshkrimit të emrave të huaj të përveçëm (sipas shqiptimit në gjuhët përkatëse), çdo mënyrë tjetër e të shkruarit të tyre është thyerje e normës së drejtshkrimit.

2. Thyerja e normës drejtshkrimore të emrave të përveçëm të huaj në botimet letrare

Botimet e përkthyer mund t'i ndajmë në dy grupe:

(a) botime ku zbatohen rregullat e drejtshkrimit të emrave të huaj të përveçëm; dhe

(b) botime që i thyejnë apo i shtrembërojnë këto rregulla.

Këto vitet e fundit vihet re prirja e të shkruarit të emrave të autorëve të huaj sipas ortografisë në gjuhën origjinale. Përsa i përket shkrimit të emrave të personazheve (antroponimet) apo emrave të vendeve (toponimet) ekziston një rrëmujë e vërtetë.

Vihet re se kryesisht emrat e autorëve bashkëkohorë anglezë e amerikanë shkruhen sipas gjuhës origjinale p.sh. **Dan Brown**. Në librin *Harry Potter* të përkthyer nga Amik Kasoruh, botim i vitit 2000 vemë re se emri i personazhit

kryesor, sipas të cilit ka marrë titullin edhe libri në brendësi të librit është shkruar sipas drejtshkrimit të gjuhës shqipe, d.m.th. sipas shqiptimit në gjuhën origjinale. Edhe emri i autorit J. K. Rowling është shkruar sipas grafisë angleze.

Në librin *Kodi i Da Vinçit (The Da Vinci code)* të përkthyer nga Amik Kasoruh, botim i vitit 2003 titulli i librit është shkruar sipas drejtshkrimit të gjuhës shqipe, porse emri i autorit është shkruar sipas gjuhës origjinale **Dan Brown**. Tek falënderimi që bën autori në faqet e para, përsëri gjejmë thyerje të normës drejtshkrimore të gjuhës standarde shqipe. Veçojmë: “*dua të falënderoj botuesin, mikun tim Jaso Kaufman/.../ Heide Lange-n, /.../ Michael Palgon-in, Suzzane Henz-in/.../, Greenwich-it*”. Vëmë re se në brendësi të romanit këta emra janë shkruar jo më sipas grafisë së gjuhës origjinale, por sipas grafisë së gjuhës shqipe, duke zbatuar edhe lakimin sipas rasave të shqipes, p.sh. **Longedoni, Longedonit, Longedonin**.

Përsa u përket emrave të autorëve të huaj, tashmë të njohur prej vitesh nga lexuesi shqiptar, që deri tani janë shkruar sipas shqiptimit në gjuhën origjinale duke zbatuar grafisë e gjuhës shqipe, mund të vazhdojnë të shkruhen po ashtu edhe për një periudhë kohe të gjatë, sepse lexuesit janë familjarizuar me ta, por mendohet se do të vijë një ditë që edhe ata do të shkruhen si në gjuhën origjinale, sepse njerëzit do të jenë familjarizuar me gjuhën angleze për arsyt që përmendëm më sipër. Megjithatë, edhe disa prej këtyre emrave i gjejmë të shkruar në forma të ndryshme, p.sh. librin *Hamleti, princ i Danimarkës* të shqipëruar nga Fan Noli, botim i shtëpisë botuese “Argeta-LMG” e gjejmë me emrin e autorit të shkruar sipas gjuhës angleze “**Shakespeare**”. Po të njëjtin libër, por të botuar nga një tjetër shtëpi botuese, “Onufri” e gjejmë me emrin e autorit të shkruar sipas traditës së deritanishme “**Shekspir**”.

3. Shkelje e normës drejtshkrimore në botimet shkollore

Edhe në tekstet shkollore vihen re shkelje të rregullave të drejtshkrimit të emrave të

përveçëm anglo-saksonë e amerikanë. Më të theksuara janë këto shkelje në drejtshkrimin e toponimeve. Po sjellim disa raste: *Letërsia 4* (për shkollat e mesme, f. 181), “**Xhejms Xhois**” (sipas shqiptimit duke zbatuar ortografinë e gjuhës shqipe). Po aty lexojmë: “/.../ Në vitin 1888 prindrit e regjistrojnë në **Clongowes Wood Colleg/.../ Më 1898 Xhojsi regjistrohet në University College**”.

Këto kohët e fundit vihet re se emrat e disa autorëve të vjetër për drejtshkrimin e të cilëve tashmë është krijuar një traditë, në botimet e disa shtëpive botuese private vihet re thyerja e normës drejtshkrimore. Vlen për t’u përmendur këtu njëra prej veprave të shkrimtarit të njohur anglez Uilliam Shekspir, titulli i të cilit paraqitet me grafi të ndryshme.

4. Thyerje e normës në shtypin e perditshtëm

Gjuha e mjeteve të informimit duhet të jetë shprehëse e vlerave kombëtare. Kujtojmë një thënie të shkrimtarit të njohur anglez Oskar Uajld (Oscar Wilde) se: “*i vetmi ndryshim që ndodh midis letërsisë e gazetarisë është ky: gazetaria është e palexueshme, ndërsa letërsia e lexuar*”.

Lind pyetja: a po e kryejnë mjetet e informimit rolin e tyre shoqëror në përmasën gjuhë? A e pasqyrojnë ato gjuhën standarde? Veprimtaria shoqërore e mediave të shkruara e elektronike është mjaft e ndjeshme, ndërsa brenda kësaj veprimtarie del e përbërë dhe e ndjeshme veçanërisht çështja e gjuhës.

Një shoqëri e zhvilluar e me prirje zhvillimi të shpejtë duhet të ketë edhe një gazetari të zhvilluar. Në shtypin bashkëkohor, në pikpamje gjuhësore, përfshihet një spektër i gjerë e i larmishëm i shkrimeve, më i gjerë se në çdo fushë tjetër të veprimtarisë gjuhësore, sepse në gazetatat ditore e javore, në revistat javore e mujore mund të gjenden nga llojet më të ndryshme të rubrikave, duke filluar nga lajmet e informatat, raportet, komentet, artikujt imagjinarë, reportazhet, reklammat. Të gjitha këto kanë përmbajtje të ndryshme dhe mund të shkruhen, huazohen ose përkthehen nga gazetarë e autorë të ndryshëm të njohur e të panjohur, të përgatitur e të papërgatitur gjuhësisht e

intelektualisht, nga autorë profesionistë e joprofesionistë.

Vihet re se këto vitet e fundit ka pasur një prurje negative përsa i përket përdorimit të gjuhës standarde. Siç dihet, anglishtja po ushtron ndikime në shumë gjuhë evropiane, por ky ndikim po ndjehet edhe në gjuhën e sotme shqipe, sidomos nga vitet '90 të shekullit të kaluar e në vazhdim. Kanë vërshuar anglicizma, sidomos në publicistikë. Kështu p.sh., në shtyp këto anglicizma zënë vendin e parë ndër fjalët e huaja.

Një ndër problemet që vlen të diskutohet përsa u përket këtyre anglicizmave në gjuhën shqipe, është edhe mënyra se si po shkruhen në gjuhën shqipe emrat e përveçëm me origjinë anglosaksone e amerikane. Vihet re thyerje e normës së gjuhës standarde shqipe. Po e ilustruam me disa shembuj: Një luhatje e theksuar vihet re ne drejtshkrimin e fjalës **Evropë**, e cila shpesh gjendet e shkruar **Europë**. Në të njëjtin numër gazete mund t'i takojmë të dyja trajtat. Sipas drejtshkrimit të gjuhës shqipe duhet të shkruhet *Evropë*, por sot duket si më e përshtatshme të shkruhet *Europë*, sepse është më e lehtë për t'u shqiptuar, përputhet me shkrimin e disa gjuhëve të tjera evropiane, si dhe me shkrimin e shqiptimitin e fjalës së re EURO, e cila tashmë ka hyrë në gjuhën shqipe pikërisht në këtë trajtë: euro, euroja, eurot.

Vihet re shkrimi i emrave të përveçëm anglezë, si në gjuhën origjinale duke thyer kështu normën e drejtshkrimit të tyre në gjuhën shqipe dhe njëkohësisht, edhe ligjet morfo-sintaksore të gjuhës letrare. E ilustruam me disa shembuj: Në Gazetën "Shqip" (9 qershor 2007): "Nëse **Xhorxh Bush** sëmuret, urgjent në spitalin turk". Në "Panorama" 11 tetor 2007 lexojmë: "**Pack** ka bërë të ditur se presidenti kërkon që kjo çështje të zgjidhet nga presidenti".

Emri është shkruar duke zbatuar ortografinë e gjuhës shqipe, sipas shqiptimitit në gjuhën origjinale dhe, deri këtu themi se është zbatuar drejtshkrimi i gjuhës shqipe, por siç e dimë, gjuha shqipe ka trajtë të shquar e të pashquar të emrit, e cila shprehet me anë të mbaresave dhe këtë e shtrin edhe tek emrat e përveçëm qofshin këta

shqiptarë, të huazuar, apo të huaj. Kështu kur një person përmendet me emër e mbiemër, emri shkruhet në trajtën e pashquar, kurse mbiemri në trajtën e shquar, pra, duhet thënë: **Xhorxh Bushi** e jo **Xhorxh Bush**.

Në të njëjtën gazetë në një rast tjetër thuhet: "*Barrikadat nuk thyhen, emri i **Bushit** në tjetër rrugë*". Po aty lexojmë: "*Petiffer* (mungon mbaresa e shquarësisë) *studiuës i njohur britanik i çështjes shqiptare flet për vizitën e **Bushit** në Tiranë*" (kemi mbaresën e shquarësisë). Vemë re se i njëjti emër shkruhet në dy variante: (a) sipas shqiptimitit në gjuhën angleze, por duke zbatuar rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe; dhe (b) sipas ortografisë në gjuhën angleze duke thyer normën e drejtshkrimit në gjuhën shqipe.

Po t'i referohemi *Rregullave të pikësimit në gjuhën letrare shqipe* (projekt), botim i Akademisë së Shkencave i vitit 1981 lexojmë: "Përdorimi i kllapave të rumbullakta: Shkruhen me kllapa të rumbullakta emrat e përveçëm të huaj me drejtshkrimin e gjuhës përkatëse kur jepen krahas transkriptimit të tij në gjuhën shqipe: **Shekspir (Shakespeare), Shopen (Chopin)**" (1981: 71). Pra, vemë re se as kjo pikë e rregullave të pikësimit nuk zbatohet në këto gazeta.

Ndodhin edhe paradokse të tilla që në ndonjë gazetë, nga njëra anë shohim të shkruhet me gërma të mëdha titulli i ndonjë artikulli, ku jepet alarmi se gjuha jonë sot rrezikohet për shkak të shkëlqeve të rregullave të drejtshkrimit; dhe nga ana tjetër, në po këtë gazetë gjejmë dhjetra shkëlqje gjuhësore.

Kështu për shembull në gazetën "*Shqip*" të datës 21 shtator botohet shkrimi me titull "*Brenda shekullit, 3000 gjuhë më pak*". Ky alarm jepet me të drejtë, sepse sot krahas rrezikut të zhdukjes së kafshëve e bimëve që tashmë është evident, ekziston edhe një rrezik tjetër, ai i zhdukjes së shumë gjuhëve në botë. Sipas linguistëve, mesatarisht çdo dy javë zhduket një gjuhë në një cep të planetit dhe brenda këtij shekulli gjysma e gjuhëve të folura në botë mund të përfundojnë në harresë, duke marrë me vete edhe një bagazh të madh kulturor. Të dhënat e lartpërmendura i gjejmë të botuara edhe në këtë artikull, por po në

këtë numër të kësaj gazete mund të lexojmë artikuj ku ka shumë shkelje drejtshkrimore të gjuhës shqipe, sidomos në drejtshkrimin e emrave të përveçëm anglezë e amerikanë. Po sjellim disa shembuj: “Ambasadori amerikan: Jemi të vendosur për Kosovën; **Withers** në “**Top Story**”; “**Bechtel**”, presim hetimin”; “Një nga personalitetet kyç që është në SHBA, **Alan Greenspa**, i cili sapo ka botuar një libër”. Po në këtë numër të kësaj gazete lexojmë: “Zoti **Uithers** do të doja të ndaleshim në situatën në vend...”

5. Konkluzione

Në një nga numrat e gazetës “SOT” të datës 19 shtator 2007 në faqen e parë të tërheq vemendjen titulli i një shkrimi: “Flet Prof. Dr. Gjovalin Shkurta: Të hyjmë në Evropë me kulturë gjuhësore”. Një nga pyetjet që gazetarja i bën profesorit është se sa i zbatojnë mediat në vendin tonë rregullat e gjuhës shqipe. Profesori përgjigjet: “Mediat përfaqësojnë një situatë të zhvillimit në Shqipëri. Në çdo vend të qytetëruar punonjësit e mediave janë përhapës dhe tejçues të gjuhës së shkruar dhe të normës së gjuhës së folur, të shqiptimit e të intonacionit standard. Ne duam që gazetarët të jenë mbështetës të gjuhës standarde shqipe. Nuk mund të kemi një standard të mirë nëse do të kemi gazetarë që nuk e shkruajnë gjuhën shqipe mirë dhe nuk mund të kemi kulturë gjuhe nëse nuk kemi njerëz që flasin bukur në radio e televizion”. Prandaj “Gjuhëtarët dhe opinioni shoqëror janë të shqetësuar për dëmin që po i shkaktohet gjuhës shqipe nga vërshimi i fjalëve dhe i ndërtimeve të huaja.. Krahas llojeve të tjera të ndotjes sot mund të

flasim edhe për një “ndotje gjuhësore”. Në fushën e fjalorit kjo shfaqet me përdorimin e fjalëve të huaja të panevojshme” (Ajeti 1997).

Bibliografi

- AJETI, I. (1997), *Konferencë Shkencore. 25 vjetori i Kongresit të Drejtshkrimit*, Tiranë.
- LAJE, E. (1997), Njëzet e pesë vjet nga Kongresi i Drejtshkrimit: *Konferencë Shkencore. 25 vjetori i Kongresit të Drejtshkrimit*, Tiranë.
- ÇABEJ, E. (), *Për pastërtinë e gjuhës*, Tiranë.
- ÇELIKU, M. (2002), Shmangia në fushë të gramatikës e të drejtshkrimit në shqipen standarte. Fund i shek XX- fillim i shek XXI: KONF
- ÇELIKU, M. (1997), Kongresi i Drejtshkrimit dhe norma gramatikore: *Konferencë Shkencore. 25 vjetori i Kongresit të Drejtshkrimit*, Tiranë.
- ÇELIKU, M. (1982), Shquarja e emrave të përveçëm në gjuhën shqipe: *Studime filologjike*, Tiranë, nr. 2.
- KOSTALLARI, A. (), Njerëzit dhe emrat: *Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës*, f. 261-371.
- KOSTALLARI, A.(1973), *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, Tiranë.
- LLOSHI, Xh. (), Facing the globalization; the case of the Albanian Language: *Studio Albanica*
- SHEHU, H. (2002), Rreth anglicizmave në mjetet e sotme të informimit masiv: *Kon. Shk. 2002*
- TOPALLI, N. (1991), Rreth trajtës së toponimeve të huaja në shqipe: *Gjuha jonë*, Tiranë, nr. 2.
- X x x x (1981), *Rregullat e pikësimit në gjuhën letrare shqipe (projekt)*, Tiranë..